



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

Data 12.10.2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Kuotë Ushqimore Kopësht dhe Çerdhe”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Produkte shtazore dhe produkte të përafërta 03140000-4; Drithera, patate, perime, fruta dhe arra 03200000-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**5 250 000 (pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh me burim financimi “Te ardhurat e QAB – Vetefinancim”**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formulari ofertes sipas shtojces 1.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2019,2020 dhe 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. Në plotesimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqese: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlere eshte percaktuar referuar nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 29, pika 1, te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998 Per Tatimin mbi te Ardhurat, i ndryshuar, ku **parashikohet se:** “Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel, se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.”

Gjithashtu përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë operatorët ekonomike pa kufiizim.

2.2.2. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 dhe 2022, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

(Pika 2.2.2 e kapacitetit ekonomik dhe financiar do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazes së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, nenin 39 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

- Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme për kontratat e mallrave dhe shërbimeve në një vlerë jo më pak se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me institucione shtetërore/ente publike, operatorët ekonomik duhet të paraqesin vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e furnizimeve ose faturën/faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- License kategoria: **II.1.A. 1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”**, të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

*Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II.1A.1 – “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz”, në emër të tij, pasi licenca duhet t’i përket operatorit ekonomik të interesuar të ofertojë për procedurë e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor. Ta posedoj op.ekonomik ose kontrata bashkëpunimi me një op.ekonomik që e posedon këtë license.*

*Kriteri është vendosur për të garantuar që produktet që ofrohen të jenë nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe që garanton cilësi dhe siguri për konsumatorin. Për të mos qenë kriteri diskriminues dhe për të garantuar konkurrencë të lirë dhe të pakufizuar është vendosur dhe opsioni I bashkëpunimit me op.ekonomik të licensuar sipas legjislacionit në fuqi bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,*

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme, si më poshtë:

- Çertifikata e Menaxhimit të Cilësisë (ISO) 9001:2015, e vlefshme, për cilësinë e mallrave/produkteve ushqimore, ose ekuivalente, e vlefshme.

- Çertifikata e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore (ISO) 22000: 2018, ose ekuivalente, e vlefshme.

**Shënim:** Çertifikata ISO duhet të jetë leshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga

Republika e Shqipërisë. **Në rastet e bashkimit** të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën, ISO në përputhje me % e bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së produkteve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Përmbushja e standartit (ISO) 22000: 2018 ose ekuivalente është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e sigurisë ushqimore të produkteve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik përmbush kontratën sipas të gjitha standarteve ushqimore.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetedeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU-se, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.5** Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim një automjet të përshtatshëm frigoriferik për të bërë transportimin e mallrave pranë kopshtit dhe Cerdhes të vertetuar me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor, leje qarkullimi, policen e sigurimit, certifikata e kontrollit teknik si dhe certifikate pronësie të mjetit. Në rast se mjeteve është marrë me qera të shoqërohet me kontrata qeraje noteriale.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri është vendosur për të garantuar që produktet që ofrohen të jenë nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe që garanton furnizimin sipas sasive të përcaktuara dhe afateve përkatëse dhe sipas kushteve higjieno sanitare dhe ruajtjes së produktet sipas kushteve dhe normave për të garantuar cilësi dhe siguri për konsumatorin.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

## **NJESIA E PROKURIMIT**